



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

RAPORT PËR REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK TË
PROJEKTLIGJIT:

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

1. Titulli i projekt aktit

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky projektligj ka për qëllim përmirësimin e ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura”, i ndryshuar, duke plotësuar dhe saktësuar disa mangësi që janë evidentuar ndër vite, gjatë zbatimit të tij.

Ligji i sipërcituar përcakton në tërësinë e tij statusin e ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke i vendosur kësaj kategorie të veçantë shoqërore disa detyrime dhe njohur disa të drejta të përfituara sipas qëllimit që ka statusi i personelit ushtarak aktiv, që shërben në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në mbrojtje të interesave të vendit dhe kryerjes me përgjegjësi të lartë të detyrave.

Nëpërmjet projektligjit të paraqitur synohet të bëhen disa rregullime dhe ndryshime në përmbajtje që prekin disa prej neneve të ligjit dhe konsistojnë në përmirësimin e mbështetjes për ushtarakun dhe familjen e tij, në përputhje me kontekstin e realitetit të ndryshuar, krahasuar me kohën kur është miratuar ligji dhe përafrimin me standarde të ngjashme për mbështetjen e ushtarakut nga vendet anëtare të NATO-s.

Për vetë objektivin e rëndësishëm që kanë Forcat e Armatosura, rregullimi i veçantë, për sa i përket administrimit të jetës së përditshme të ushtarakëve, është i domosdoshëm.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Dokumenti u publikua në RENJK në adresën “konsultimipublik.gov.al”, në datën 22.1.2025 për marrjen e komenteve dhe rekomandimeve nga qytetarët dhe shoqëria civile, deri në datën 19.2.2025, duke respektuar afatin ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, janë si më poshtë:

- Njëpërmjet publikimit në RENJK,
- Njëpërmjet adresës së emailit: konsultim.publik@mod.gov.al:

Me qëllim lehtësimin e dhënies së komenteve/sugjerimeve nga çdo i interesuar, në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, në rubrikën e dedikuar për konsultimin publik, krahas drafteve të projektligjit është vënë në dispozicion edhe një adresë elektronike.

- Njëpërmjet adresës postare: “Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej”, Tiranë:

Çdo palë e interesuar pati mundësinë të dërgojë në formë shkresore, në adresë të Ministrisë së Mbrojtjes të gjitha komentet/sugjerimet mbi përmbajtjen e projektligjit.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Projektligji është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Projektligji i është dërguar për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si dhe Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Numri i shikimeve në RENJKP për këtë projektligj ishte 3740 dhe procesi i konsultimit është shoqëruar me komente nga qytetarët, të cilat paraqiten më poshtë:

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Kreditë e lehtësuara për të	“Në lidhje me nenin 18 sugjerimi im do të ishte që edhe	Qytetar	Refuzuar	Sugjerimi i komentuesit lidhet me mundësinë që

punësuarit e administratës publike.	ushtaraket e tjerë që shërbejnë në forcat e armatosura, pavarësisht se mund të kenë një banesë në pronësi në emër të tyre apo familjareve të tyre, në rast se nuk kanë përfituar asnjëherë nga lehtësirat e ofruara si kredi me interes të ulët apo më interes 0%, të marrin një pagesë suplementare për banesë, pasi ata kanë krijuar të ardhurat e banesës së tyre nga puna e tyre dhe jo si përfitim i të qenurit ushtarak. Aq më shumë ka shumë ushtarake të cilat kanë aplikuar për kredi me interesat e tregut. Ndaj mendoj që për këtë kategori ushtarakësh të ofrohet pagesa e interesave nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes për një trajtim të barabartë për të gjithë ushtaraket.”			edhe ushtarakët aktivë të që kanë në pronësi një banesë të përshtatshme të përfitojnë kredi të lehtësuar për strehim. Sqarojmë se trajtimi i kredive të lehtësuara për strehim, për punonjësit e administratës publike është i rregulluar nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, konkretisht: Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, i cili përcakton parimet, kriteret dhe programet e strehimit për individët dhe familjet në nevojë. VKM nr. 468, datë 26.7.2023 “Për trajtimin me kredi të lehtësuar të të punësuarve në administratën publike për blerjen e banesës”, e cila ka shfuqizuar VKM nr. 452, datë 9.7.2004 “Për
--	--	--	--	---

			kriteret e dhënies së kredisë për strehim ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) dhe masën e kësaj kredie. Ky vendim ka unifikuar trajtimin e të punësuarve në administratën publike, përfshirë ushtarakët, në një skemë të vetme. Programi i kredive të lehtësuara ka një qëllim social, i cili synon të mbështesë individët dhe familjet që nuk kanë zgjidhje të përshtatshme strehimi. Sipas VKM nr. 468/2023, përfitues të kredisë së lehtësuar janë vetëm ata që nuk kanë në pronësi një banesë të përshtatshme për strehim. Ky kriter është vendosur pikërisht për të garantuar që përfitimi të shkojë tek të pastrehët ose personat që kanë
--	--	--	---

				nevojë për strehim të parë. Prandaj, kërkesa që edhe ushtarakët aktivë të cilët kanë një pronësi një banesë të përshtatshme të përfitojnë kredi të lehtësuar për blerjen e një banese tjetër nuk është në përputhje me objektivat sociale të programit dhe legjislacionit aktual. Projektligji për ndryshimin e ligjit nr. 9210/2004 nuk përfshin ndryshime për këtë çështje dhe nuk është instrumenti i duhur për ta adresuar.
Promovimi në karrierën ushtarake	Jemi afro 20 kapitenë që për shkak të konkurrencës të disa viteve më parë nuk arritëm të promovohemi për marrjen e gradës së radhës Major. Aktualisht numri i përgjithshëm i oficerëve është i ulët, krijimi i strukturave të reja ku ka shumë	Qytetar	Refuzuar	Ky koment lidhet me çështjet e karrierës dhe promovimit në Forcat e Armatosura, të cilat nuk janë objekt i këtij projektligji. Rregullimi i këtyre çështjeve është pjesë e ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën në FARSH”. Ky

	vakanca. Përse mos të ndërmerren nisma për përmirësimin e ligjit që dhe ne të promovohemi në gradë dhe të vazhdojmë karrierën.			projektligj ka për qëllim vetëm ndryshimin e ligjit nr. 9210 dhe nuk përfshin ndryshime në sistemin e karrierës apo promovimit të ushtarakëve.
--	---	--	--	---